



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më _____

Dokument parlamentar
(Komision përgjegjës)

RAPORT

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË STRUKTURËN, ORGANIKËN DHE NUMRIN E PUNONJËSVE TË KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, bazuar në kalendarin e punës së tij, në datën 12.07.2018 mori në shqyrtim në cilësinë e Komisionit përgjegjës, propozimin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për ndryshime në strukturën, organikën dhe numrin e punonjësve të këtij institucioni.

Të ftuar në mbledhje për të parashtruar shpjegimet mbi kërkesën për ndryshime në strukturën dhe organikën ekzistuese, ishte Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Z.Robert Gajda.

Ndërkohë Komisioni kishte ftuar në degjësë edhe përfaqësues nga Ministria e Financave për t'u shprehur në këndvështrimin buxhetor lidhur me efektet financiare që sjellin këto ndryshime.

Opozita nuk ishte e pranishme.

Komisioneri shkurtimisht njohu Komisionin me arsyet pse kërkohet ky riorganizim me shtim funksionesh të reja të cilat do të adresojnë më mirë nevojat dhe përmbushjen e detyrimeve të rekomanduara në strategji kombëtare dhe nga organizmat ndërkombëtare, si rrjedhojë kërkohet të shtohet numri total prej 11 punonjësish, *2 nga të cilët janë të mbuluar me ligjin e buxhetit të shtetit për vitin 2018. Pra kostoja financiare shtesë është për 9 punonjës.*

Komisioni gjatë shqyrtimit të kërkesës, analizoi se :

Nga ana ligjore :

Kjo kërkesë vjen në mbështetje të nenit 21, pika 3 e ligjit Nr. 10221, date 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", i cili përcakton kompetencën ligjore të Kuvendit të Shqipërisë për miratimin e propozimeve për strukturën organizative të institucionit të KMD.

Komisioneri ka paraqitur propozimin duke u bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, ligji 9584/2006 për pagat dhe VKM për hartimin e strukturave dhe përcaktimin e pozicioneve të punës.

Struktura aktuale në fuqi e KMD është e miratuar me vendimin e Kuvendit të Shqipërisë Nr. 34, date 20.05.2010, sipas të cilit numri total i punonjësve në këtë Institucion është **23 punonjës të organizuar në 3 drejtori dhe një sektor**.

Me propozimet e reja, struktura përbëhet në mënyrë horizontale nga 5 drejtori.

Nga ana e efektit financiar : KMD është është institucion i pavarur që financohet nga buxheti i shtetit ndaj dhe propozimet për shtesa dhe klasifikime të pagave të punonjësve të ndryshëm kanë efekte financiare në ligjin e buxhetit të shtetit.

Ligji i buxhetit të shtetit Nr. 109/2017, në nenin 11 të tij përcakton se *“Për vitin 2018 nuk miratohet asnjë ndryshim në strukturat organike të njësisë të qeverisjes qendrore me efekte financiare shitesë në koston e personelit, të përlllogaritur sipas strukturës së miratuar, me përjashtim të institucioneve të reja dhe institucioneve të sistemit të drejtësisë”*. Në relacionin e paraqitur, KMD ka paraqitur edhe efektet financiare që prekin buxhetin e shtetit.

Komisioni ka administruar përgjigjen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë si një detyrim ligjor, e cila shprehet se propozimet sjellin efekte që bien ndesh me përcaktimet e nenit 11 për buxhetin e shtetit për vitin 2018.

Komisioni ka administruar edhe përgjigjen e Departamentit të Administratës Publike në këndvështrim të respektimit të normave dhe rregullave sipas VKM 893/2014 dhe 187/2017.

DAP shprehet lidhur me pamundësinë e klasifikimit ndryshe të pagës për pozicionin “inspektor” pasi nuk është i parashikuar në VKM 187/2017 si dhe faktin e një emërtese më të përshtatshme të Drejtorisë së Marrëdhënieve me Jashtë në raport me funksionet që do të kryejë.

Në vlerësimin e tij , relatori i Komisionit mbajti në vëmendje:

- Ligji organik , ligji 9584/2006, i ndryshuar, për pagat , ligji 109/2017 për buxhetin e vitit 2018;
- Rezoluta e Komisionit të ligjeve e votuar nga Kuvendi për vlerësimin e veprimtarisë së punës për vitin 2017 të KMD me një sërë kërkesash të shtuara ;
- Raporti i Komisionit European i vitit 2018;
- Përgjigjia e ardhur nga Ministria e Financës dhe DAP;
- Misioni i KMDs, strategjia institucionale dhe objektivat e shtuar ligjorë të tij ;
- Struktura ekzistuese e KMD, e pandryshuar në 8 vite që nga krijimi i institucionit dhe treguesit kryesorë të punës për çdo funksion;
- Vlerësimi i impaktit të punës për çdo funksion dhe mangësitë e hasura si dhe nevoja reale për konsolidim të stafit mbështetës;
- Aktet ligjore dhe nënligjorë në fuqi;
- Mekanizmi ndërinstitucional i krijuar nga Kuvendi me vendimin 49/2017 për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura, ku duhet një analizë dhe raportim i shtuar i punës dhe monitorimit të strukturave të zbatimit të ligjit .

Relatori i çështjes, vlerësoi se struktura gjëndet e përputhur në aspekt të ndërtimit, konceptimit dhe misionit të KMD ndërkohë që kostoja financiare për të bërë të mundur këtë strukturë, është çështje e zbatimit të ligjit të **buxhetit të shtetit për vitin 2018**.

Në përfundim, anëtarët e komisionit vlerësuan se kjo kërkesë duhet marrë në konsideratë për nevojën reale të ndryshimeve në institucion, por në këndvështrimin buxhetor, bazuar edhe në mendimin e shprehur nga Ministria e Financave, propozimet e ardhura në këtë periudhë të mesvitit të zbatimit të ligjit të buxhetit të shtetit, nuk mund të mbulohen me fonde shitesë buxhetore. Për sa më lart, Komisioni me votat e shumicës së anëtarëve të tij, miratoi projekt-vendimin me ndryshimet përkatëse të propozuara në strukturën dhe organikën e KMD duke mbajtur parasysh edhe vërejtjet e DAP, **por me kushtin e mbulimit të koston financiare me ligjin e ri të buxhetit të shtetit për vitin 2019**.

RELATOR

Bashkim Fino

KRYETAR

Ulsi Manja